



Prishtinë: 02.09.2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1390\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2175\_05\_21** i dt. **28.05.2021**;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 05.07.2021;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit S.M nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2175\_05\_21, i datës 28.05.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve në ZRrE me datë 28.05.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2175\_05\_21, me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit S.M nga Komuna e Prishtinës, lidhur me kontestimin e ndërrimit të grupit tarifor.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, brenda afatit ligjor konsumatori S.M ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRrE-së për këto shkaqe:

- Pas ankesës së bërë në ZRrE i është thënë që ormani të vendoset jashtë objektit dhe se një gjë të tillë e ka bërë. Ka bërë ankesë në KEDS për 7-8 herë mirëpo nuk është ndërmarrë asnjë veprim.
- Kërkon që borxhi t'i korrigojë sepse ekzistojnë proceset e komisionit të KEDS-it në të cilat thuhet se ora nuk duhet të bartet, por që ora është bartur dhe faturat kanë ardhur në lokacionin në Hajvali.
- Nuk ka pranuar asnjë njoftim nga KEDS-i se si të veprojnë, as gojarisht e as me shkrim dhe se borxhi është bërë në amvisëri (kati i dytë).

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 00.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRrE-së ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes provat si në vijim: Ankesa e konsumatorit ne KESCO e datës 08.12.2016, Procesverbali i inspektimit nr.2119427 i datës 04.08.2017, Ankesa e konsumatorit ne KESCO e datës 28.07.2017, Procesverbali i inspektimit nr.2160952 i datës 23.10.2017, Procesverbali i ndërrimit të njehsorit nr.0653997 i datës 09.12.2017, Protokoll i Qendrës së Kalibrimit nr.org.02, nr.3853 i datës 12.02.2018, Procesverbali i inspektimit nr.2141878 i datës 21.03.2018, Përgjigjet e KESCO-s e datës 15.12.2017, Ankesat e konsumatorit në DMK të ZRRE-së me datë 27.12.2017, Rrjedha e energjisë elektrike aktive dhe Transaksionet e konsumatorit.

Pas trajtimit të këtyre provave, Bordi i ZRrE-së ka konstatuar këtë gjendje faktike:

- Gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit nr.04657258 prej TL=007285 kWh dhe TU=002350 kWh e evidentuar në procesverbalin e inspektimit nr.2119427 të datës 04.08.2017 **përputhet** me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive të periudhës 07/2017. Duhet theksuar se në procesverbalin e inspektimit në fjalë, punëtorët e autorizuar të KEDS-it përveç tjerash kanë theksuar se këtij konsumatori **duhet t'i ndërrohet grupi tarifor** nga 4/02 në 7/02 dhe t'i ndërrohet adresa e veprimit të bëhet në Hajvali.
- Gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit nr.04657258 me gjendje TL=009156 kWh dhe TU=003524 kWh e evidentuar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit nr.0653997 të datës 09.12.2017 **përputhet** me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive të periudhës 11/2017. Duhet theksuar se në procesverbalin e inspektimit në fjalë, punëtorët e autorizuar të KEDS-it përveç tjerash kanë theksuar se njehsori ndërrohet me projekt të KEDS-it, dhe se njehsori "smart" vendoset në ormanin ekzistues, pasi **që nuk ka mundësi teknike për zhvendosje**.
- Gjithashtu duhet theksuar se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 23.10.2017 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit nr.04657258, por që nuk kanë evidentuar gjendjen e shpenzimit, si dhe është evidentuar se nuk mund të bëhet ndërrimi i grupit tarifor sepse nuk i plotëson kushtet teknike, si dhe njehsori elektrik është i montuar brenda lokalit dhe se njehsori duhet të montohet jashtë objektit ku ka qasje lexuesi dhe pastaj të bëhet ndërrimi i grupit tarifor.

Andaj, nga sa u tha më sipër, Bordi i ZRrE-së ka vënë re se konsumatori pas parashtrimit të kërkesës për ndërrim të grupit tarifor nga grupi tarifor 4 (komercial 7/02) në grupin tarifor 5 (shtëpiak 4/02), punëtorët e autorizuar të KEDS kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë inspektimin pikës matëse dhe kanë konstatuar se bazuar në procesverbalin e inspektimit nr.2160952 të datës 23.10.2017 është konstatuar se nuk mund të bëhet ndërrimi i grupit tarifor sepse nuk i plotëson kushtet teknike, si dhe njehsori elektrik është i montuar brenda lokalit dhe se njehsori duhet të montohet jashtë objektit ku ka qasje lexuesi dhe pastaj të bëhet ndërrimi i grupit tarifor. Gjithashtu duhet theksuar se në procesverbalin e inspektimit nr.2141878 të datës 21.03.2018, punëtorët e autorizuar të KEDS kanë konstatuar se nuk mund të bëhet ndërrimi i grupit tarifor sepse akoma është biznes, dhe se në këtë vend nuk ka banim të amvisërisë. Pra, në asnjë procesverbal të KEDS nuk është evidentuar se janë



plotësuar kushtet për ndërrim të grupit tarifor, pasi që objekti është biznes dhe se nuk përdoret për banim të amvisërisë.

Pretendimet e konsumatorit se, i licencuari KEDS nuk ka ndërmarrë asnjë veprim dhe se nuk është njoftuar, përkundër kërkesave të tij, si të tilla Bordi i ka vlerësuar si të paqëndrueshme, pasi që, siç edhe mund të vërehet nga shkresat e lëndës, konsumatori është njoftuar për nevojën e ndërrimit të grupit tarifor dhe ndërrimin e adresës, pamundësinë teknike të zhvendosjes së njehsorit smart për shkak që nuk janë plotësuar kushtet teknike, e të ngjashme.

Bordi i ZRRE-së bazuar në transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstaton se KEDS/KESCO ka respektuar nenin 28 par. 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar të zbatohet për cdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara), ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim”.*

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-së
- Konsumatorit S.M dhe
- Arkivit të ZRRE-së.